



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 31 dt.27.03.1996

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.27.03.1996, mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave (dosja e vendimit Nr.520, dt.23.11.1995) të ish pronarit Ferit Vokopola i persekutuar politik i grupit B, të studjuar dhe miratuar nga Komisioni i Shërbimeve Publike të këtij Këshilli dhe vendosi :

VENDOSI

1. Mbi bazën e ligjit Nr.7689, dt.15.04.1993 Ferit Vokopola (trashëgimtarët e tij) kompesohen me truall të lirë shtetëror me sipërfaqe 1.000 m² sipas gen – planit të hartuar nga Kadastra Urbane i cili ndodhet në anën jugore të Rr.”Ismail Qemali” (prapa pallateve italiane të Xhenjos).
2. Me vendimin e KRRT-së Nr.6, dt.12.03.1996 janë miratuar kondicionet urbanistike të sheshit të ndërtimit për banesë 5 kate.
3. Prona e Ferit Vokopolës figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr./3/6/54, dt.17.11.1928.

KRYETARI

BESNIK PETRELA